



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:244194
Datë: 08.08.2024
Numri i dokumentit: 06032884

AC-I-24-0187

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

A Sh i përfaqësuar nga avokati B I, Prishtinë.

Kundër

E paditura

Autoriteti i Likuidimit i NSH "**Famipa**" (në likuidim), të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1684 të datës 16 shkurt 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 08 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1684 i datës 16 shkurt 2024, dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit, PRZ024-0139 i datës 02 shtator 2013.**

3. Obligohet e paditura ti paguajë paditësit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës shumën prej 1,260.00 euro, në emër të interesit ligjore prej 10%, shumën prej 126.00 euro si dhe në emër të shpenzimeve të përfaqësimit nga ana e avokatit shumën prej 208.00 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 10 shtator 2015, paditësi e ka dorëzuar një ankesë në DHPGJS dhe ka kërkuar që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ024-0139 i datës 02 shtator 2013, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,260.00 euro, me arsyetim se për periudhën para lidhjes së Kontratës së privatizimit i njëjti nuk ka qenë punëtorë aktiv në ndërmarrje, nuk ka qenë në listën e pagave dhe nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në, andaj ai nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, që ti njihet e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Paditësi në ankesë ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, pasi që marrëdhënia e punës i është ndërprerë me njoftimin e AKP-së, për shkak të privatizimit të NSH-së, andaj ai pohon se ka të drejtë në kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Me datë 22 janar 2024, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka përcaktuar saktë periudhën për të cilën kërkon kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Tutje AKP-ja pohon se sipas listës së pagave të punëtorëve, paditësi nuk ka punuar dhe nuk ka ofruar shërbime për NSH-në, ai nuk ishte punëtorë aktive i NSH-së, prandaj nuk ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës të pretenduara

ndaj NSH-së. Në mbrojtën në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 16 shkurt 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-15-1684, ankesën e paditëses e refuzon si të pa bazuar, dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se pas shqyrtimit të provave të lëndës, pretendimeve dhe parashtrimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundim se parashtruesi i padisë nuk ka qenë punëtorë aktive në NSH në momentin e privatizimit të NSH-së. Tutje shkalla e parë e DHPGJS-së ka pohuar se paditësi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante për të dëshmuar se ka pasur të themeluar marrëdhënien e punës NSH dhe se i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të procedurës së privatizimit. Andaj në mungesë të dëshmive, është refuzuar ankesa e paditësit si e pa bazuar, dhe është vërtetuar vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 18 mars 2024, paditësi (në tekstin e mëtejme ankuesi) në DHPGJS ka dorëzuar një ankesë të afatshme kundër Aktgjyimit të shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-15-1684 të datës 16 shkurt 2024, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar. Për më tepër në ankesë ankuesi pohon se ka qenë punëtorë i NSH-së nga data 14.09.1979 e deri me 16.09.2011 dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës i ka ardhur si rezultat i likuidimit të NSH. Tutje pohon se ai i është përmbajtur Njoftimit të AKP-së dhe me datë 10.07.2013 ka parashtruar kërkesën e tij lidhur me kompensim, e drejtë kjo e garantuar me Ligjin e Punës. Ankuesi ka pohuar se e drejta e tij nuk buron nga kontrata e punës së punëtorit me punëdhënësin, por është e garantuar me ligj dhe bazohet në vitet e përvojës së punës. Në ankesë ankuesi i përmend disa raste të jurisprudencës së Kolegjit të Apelit. Në fund ankuesi nga Kolegji i Apelit ka kërkuar që ankesa e tij të aprovohet në tërësi si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i ankimuar, dhe të obligohet AKP që tja paguajë kompensimin e pagave në shumën e kërkuar, kamatën si dhe shpenzimet e përfaqësimit. Bashkë me ankesë ka sjellë kopjen e Librezës së punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, vendimin e Autoritetit të Likuidimit, dhe kopjen e ankesës kolektive të dorëzuar në DHPGJS me datë 25 shtator 2013.

Me datë 13 maj 2023, AKP-ja e dorëzon një parashtrësë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankuesit. Në këta parashtrësë AKP-ja pohon se ajo e mbështet në tersi Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankueses si të pabazuara. Tutje AKP-ja pohon se ajo qëndron ende pranë gjitha thënieve dhe provave të paraqitura para Shkallës së I-rë të DHPGJS në rastin C-IV-15-1684, me të cilat AKP-ja i ka hedhur poshtë të gjithë pretendimet e paditëses në padinë e saj, dhe këto argumente nuk do të përsëriten më, ngase nuk shërbejnë për mbarëvajtjen e procedurës. Andaj nga këto arsye AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar Shkallës së I-rë të DHPGJS, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të ndryshohet, dhe padia të aprovohet si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e datës 10 korrik 2013 për kompensimin e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,260.00 euro, me vendimin PRZ024-0139 të datës 02 shtator 2013, refuzohet si e pa bazuar, me arsyetimin se paditësi nuk ishte listën e pagave të NSH-së 6 muaj para privatizimit të saj, dhe nuk ishte punëtorë aktiv.

Paditësi në ankesën e dorëzuar në DHPGJS me datë 10 shtator 2015 me të cilën ai e konteston vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ024-0139, të datës 02 shtator 2013, ai kërkon dëmshpërblim për shkak të largimit të saj nga puna si rezultat i privatizimit të NSH-së, dhe atë 7 paga në bazë të përvojës së saj të punës, në shumë prej 1,260.00 euro.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së në mungesë të provave e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar, duke vlerësuar se kjo kërkesë nuk i përmbush kriteret nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, pasi që ankuesi nuk ka sjellë dëshmi në mbështetje të ankesës, kontratë të punës të lidhur me ndërmarrjen, listë të pagesës të bërë në emër të pagave, Librezë të punës që do të dëshmonte se ka qenë në marrëdhënie punë me NSH-në, dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë për shkak të procesit të likuidimit të NSH-së. Këto të gjetura faktike të shkallës së I-rë të DHPGJS-së në këtë lëndë janë të sakta, pasi që paditësi nuk ka sjellë ndonjë provë konkrete.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në shkallën e dytë, ka sjellë kopjen e Librezës së punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, vendimin e Autoritetit të Likuidimit, dhe kopjen e ankesës kolektive të dorëzuar në DHPGJS me datë 25 shtator 2013, të cilat prova në këtë fazë të procedurës në interes të arritjes së drejtësisë, duke u bazuar në nenin 70 të LDHP-së pranohen nga Kolegji i Apelit.

Në këtë lëndë duhet vlerësuar nëse paditësi me provat e ofruara ka dëshmuar se i plotëson kriteret ligjore që të i njihet e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së.

Paditësi në ankesën e tij ka pretenduar se ka punuar në NSH- deri në privatizimin e NSH-së me datë 16 shtator 2011. Këto pretendime ai i ka mbështetur me kopjen e Librezës së punës e cila është dorëzuar në gjykatë, e mbyllur me datë 16.09.2011, dhe po ashtu edhe me njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 16 shtator 2011.

Paditësi ka kërkuar 7 paga në shumë prej 1,260,00 euro, shumë të cilën AKP nuk e ka kontestuar as pranë shkallës së I-rë dhe as pranë Kolegjit të Apelit.

Kolegji i Apelit konstaton se AKP-ja e mban arkivin e NSH-së dhe ajo dëshmitë lidhur me pagat e punëtorëve të saj i ka në dispozicion, dhe nëse shuma e pretenduar prej ankuesit nuk ka qenë e saktë, atëherë AKP-ja ka mundur ta

kundërshtojë me ndonjë dëshmi se paga e tij ka qenë më e ultë nga ajo shumë që ajo pretendon.

AKP-ja ka dështuar të dorëzojë dëshmi të tilla, andaj Kolegji i Apelit e konsideron si fakt të provuar shumën prej 1.260,00 euro.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se paditësi me dëshmitë e ofruara ai ka provuar se i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, që të i njihet e drejta në kompensim të 7 pagave të pa paguara në shumë prej 1.260,00 euro, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, e cila pagesë do të bëhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paditësit i njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10%, në shumë prej 126.00 euro, ndërsa në bazë të nenit 62.2 të LDHP-së, paditësit i njihet e drejta e kompensimit të shpenzimeve të Avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditëses është aprovuar si e bazuar, është ndryshuar Aktgjykimi i ankimuar dhe padia është aprovuar si e bazuar.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 28 mars 2024, në shumë prej 20 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 08 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
